



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec

RAHOVEC /ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No. 01/23 Nr. i faq./Br.str./No.pg 76

Data/Datum/Date 28.03.2025

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 pika r) dhe s) dhe nenin 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 8 paragrafi 2 dhe nenit 9 të Ligjit Nr. 08/L-245 për Artin dhe Kulturën ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 4/2024"), nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.18 dhe 1.19 të Statutit të Komunës Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në Rahovec në mbledhjen e mbajtur me dt. 28.03.2025 miraton këtë:

V E N D I M

Për themelimin e Muzeut Etnografik në Drenoc

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës me Nr. Prot. 02/5382/25 i datës 06.03.2025 dhe merret vendimi për themelimin e Muzeut Etnografik në Drenoc.
2. Muzeut Etnografik në Drenoc do të jetë institucion kulturor lokal, i cili ka për qëllim ruajtjen, mbrojtjen dhe konservimin e materialeve etnografike, si dhe artefakteve të ndryshme me vlerë kulturore dhe historike, si pjesë e rëndësishme e trashëgimisë sonë.
3. Muzeu në funksion të realizimit me sukses të veprimtarisë, detyrave dhe kompetencave të tij do të organizojë njësitë përkatës organizative me punonjës të kualifikuar, të cilët do të përgatisin statutin dhe aktet tjera normative, të cilat do të dërgohen për miratim në Kuvendin e Komunës.
4. Selia e Muzeut Etnografik do të jetë në fshatin Drenoc, Komuna e Rahovecit, respektivisht në Parcelën Kadastrale Nr. P-71510026-00193-2 e evidentuar në emër të P.SH. SHKOLLA FILLORE DRENOC.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Kryetarit të Komunës,
- Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport,
- Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01Nr.23/25
Datë:28.03.2025

